Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY

ARRU

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË-2019

TETOR, 2020

MISIONI

"Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik"

VIZIONI

"Shërbime cilësore, të sigurta dhe efiçente të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë"

PËRMBAJTJA

1. PARATHËNIE 5
2. PERFORMANCA E KRU 5
2.1 FURNIZIMI MË UJË 6
2.1.1 Performanca jo-financiare (teknike) 6
2.1.2 Performanca jo-financiare (komerciale) 9
2.1.3 Performanca financiare 11
2.2 SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA 17
2.2.1 Performanca jo-finaciare (teknike) 17
2.2.2 Performanca jo-financiare (komerciale) 18
2.2.3 Performanca financiare 19
2.3 PERFORMANCA E PËRGJITHSHME FINANCIARE E KRU 23
2.3.1 Arkëtimi i të ardhurave 23
2.3.2 Kthimi në kapital 24
2.4 PERFORMANCA E PËRGJITHSHME E KRU 25
2.4.1 Performanca e përgjithshme - shërbimi me ujësjellës 26
2.4.2 Performanca e përgjithshme – shërbimi me ujëra të ndotura 27
2.4.3 Performanca e përgjithshme e KRU 29
3. PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT MË SHUMICË 31
4. KUALITETI I TË DHËNAVE 32
5. KONKLUZIONE TË PËRGJITHSHME 34
SHTOJCA 1: Pasqyrat përmbledhëse të të ardhurave (URRK) 35
SHTOJCA 2: Detajet e kontaktit 39
SHTOJCA 3:Harta e mbulueshmërisë me shërbime 40

Akronimet

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
BPRR	Biznes Planet Rregullatore
BRRA	Baza Rregullatore e Aseteve
BD	Bordet e Drejtorëve
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
KNMU	Këshillit Ndërministror për Ujëra
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
NJPM-NP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
QU	Qendra e Ujit
UPF	Uji i Pa-Faturuar
UA	Udhëzimi Administrativ
UKRR	Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator
O.SH	Ofruesit e Shërbimeve
SIG	Sistemi Informativ Gjeografik
TKP	Treguesit Kyç të Performancës
GNI	Grupi Ndërinstitucional(Qeveria, ARRU, KRU, SHUKOS).

1.PARATHËNIE



Monitorimi i performancës së ofruesve të licencuar të shërbimeve është përgjegjësi e ARRU, ndërsa rezultatet e këtij monitorimi të finalizuara dhe të paraqitura përmes këtij raporti ofrojnë për të gjitha palët e interesit dhe konsumatorët informata të rëndësishme lidhur me aktivitetet e zhvilluara dhe arritjet e ofruesve të licencuar për përmirësimin e shërbimeve të ujit gjatë vitit 2019.

Raporti pasqyron punën vjetore të shtatë ofruesve të shërbimeve, jep analiza krahasuese dhe vlerësim të arritjeve për treguesit specifikë kryesorë të performancës në raport me: performancën e tyre të mëparshme, arritjeve kundër njëri-tjetrit si dhe në raport me performancën e përgjithshme.

Fokus i ARRU-së edhe në vitin 2019, ishte puna në disa nga objektivat kryesore të cilat konsistojnë në: mbrojtjen e interesit të konsumatorëve, ngritjen e nivelit të shërbimeve të ujit dhe kujdesit për qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve.

Përmes politikës së drejtë tarifore kemi arritur që ofruesit e shërbimeve të operojnë në konsistencë me qëndrueshmëri financiare, duke mos i ngarkuar financiarisht konsumatorët. Tarifat i kemi përcaktuar në bazë të objektivave planifikuese që kompanitë i kishin vendosur në planet e tyre të bizneseve, ndërsa përmbushjen e tyre ARRU e ka monitoruar përmes një sistemi të detajuar të vlerësimit të përmbushjes se objektivave dhe vlerësimit të performancës së KRU.

Në pajtim me ndryshimet e fundit ligjore në kuadër të autoritetit është themeluar 'Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve', i cili është organ përfundimtar në procedurën administrative.
Siç edhe i gjeni të përshkruara hollësisht në raport, ofruesit e shërbimeve kanë shënuar trende pozitive në drejtim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve që ju ofrohen konsumatorëve dhe efiçencës komerciale, përderisa uji i pa faturuar mbetet ende në nivel shumë të lartë dhe pa ndonjë përmirësim substancial, edhe pse në drejtim të reduktimit të UPF përmes hartimit të strategjive dhe implementimit të planeve individuale të veprimit gjatë vitit 2019 ka pasur angazhim më të theksuar të ofruesve të licencuar të shërbimit.

Vlen të theksohet se për shkak të thatësisë gjatë vitit 2019, situatë kjo e cila akoma vazhdon, disa nga ofruesit e shërbimeve nuk kanë arritur të përmbushin obligimin për furnizim të rregullt me ujë dhe kanë qenë të detyruar të aplikojnë ndërprerje të planifikuara të furnizimit dhe menaxhim të kujdesshëm me resurse ujore.

Për shkakun e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, këtë vit raporti vjetor i performancës është publikuar me vonesë. Ne shpresojmë se gjetjet e përshkruara në këtë raport do të jenë një referencë pune sidomos për Bordet e Drejtorëve dhe Menaxhmentin e ofruesve të shërbimeve në mënyrë që të sigurojnë edhe me tej përmirësime në ofrimin e shërbimeve të ujit në zonat e tyre të shërbimit.

Shfrytëzoj rastin të përgëzoj stafin e ofruesve të shërbimeve për përkushtimin e vazhdueshëm rreth ofrimit të shërbimeve të ujit në situatën aktuale të shkaktuar nga pandemia si dhe stafin e ARRU në angazhimin e përpilimit të këtij raporti.

Me respekt,
Raif Preteni, Drejtor i ARRU,

2.PERFORMANCA E KRU

2.1 FURNIZIMI MË UJË

2.1.1 Performanca jo-financiare (teknike)

Cilësia e ujit

Cilësia e ujit të pijshëm e ofruar nga KRU është një tregues thelbësor për mirëqenien dhe shëndetin e popullatës.

Standardet e kualitetit të ujit të pijshëm në vendin tonë janë në përputhje me vlerat e standardeve të referuara nga Direktiva e Ujit të Pijshëm 98/83/EC e transpozuar në udhëzimin administrativ-16/2012.



Fig.1. Kualiteti i ujit për vitet 2018 dhe 2019

Gjatë vitit 2019 janë testuar gjithsejtë 9,229 mostra prej të cilave 98.8% janë në përputhje me standardet e cilësisë së ujit për pije. Sa i përket aspektit bakteriologjik janë testuar gjithsejtë 6,238 mostra ku prej tyre 99.2% e tyre kanë qenë në përputhje me vlerat parametrike të lejuara, ndërsa në aspektin e cilësisë fiziko-kimike janë testuar 2,991 mostra nga të cilat 97.9% rezultuan të jenë në përputhje me vlerat e lejuara.

Në aspektin e përgjithshëm, ka një përkeqësim të vogël prej 0.6% në raport me një vit më parë dhe kryesisht në lidhje me cilësinë sa i përket parametrave Fiziko-Kimik.

Një përmbledhje e statistikave (normave) të cilësisë së ujit të furnizuar gjatë vitit 2019, sipas KRU dhe në nivel sektori është dhënë në tabelën nr.1.

Tab. 1. Norma(%) e testeve mikrobiologjike dhe fiziko-kimike në përputhje me standardet e cilësisë së ujit sipas KRU

KRU	PR	PZ	PE	MI	GJA	FE	GJI	SEKTORI
Mikrobiologjike	100	100	99.3	99.5	100	95.5	96.9	99.2
Fiziko-Kimike	99.8	100	100	97.6	100	91.7	92.1	97.9
Mesatarja	99.9	100	99.5	99.1	100	94.5	94.9	98.8

Në mesin e shtatë kompanive KRU 'Bifurkacioni' dhe KRU 'Hidromorava' kanë nivelin më të ulët të normës së përputhshmërisë, prej 94.5% (Bifurkacioni) dhe 94.9% (Hidromorava). Këto dy KRU kanë furnizuar një cilësi më të dobët të ujit, si në aspektin bakteriologjik ashtu edhe në aspektin fiziko-kimik edhe për shkakun e mungesës së furnizimit të rregullt me ujë të pijës.

Sidoqoftë, për të siguruar një cilësi të mirë dhe të qëndrueshme të kualitetit të ujit, investimet e mëtutjeshme janë të nevojshme për pajisjen e laboratorëve dhe akreditimin e laboratorëve për kontroll më të efektshëm operacional.

Presioni i ujit

Ky tregues pasqyron përqindjen mesatare të pronave të lidhura që kanë furnizim me ujë, e që në rrethana normale nuk mund të ju garantohet presion i ujit (1.5-7 bar) në rubinetet e tyre.



Fig.2. Përqindja e pronave të cilat kanë probleme me presion të ulët

Gjatë vitit 2019 vetëm KRU 'Hidomorava' ka raportuar prona që kanë probleme me sigurimin e presionit/ nën nivelin referent dhe atë në vlerë prej 5,445 prona, kryesisht kjo është e lidhur me mungesën e furnizimit të rregullt. Shumica e KRU ende nuk kanë mundësinë që të monitorojnë dhe sigurojnë informacione të besueshme për presionet në rrjetin e tyre të shërbimit, ato nuk kanë sistem të vendosur të manometrave dhe monitorimit On-line të rrjetit shpërndarës. ARRU i ka vlerësuar me besueshmëri të dobët të dhënat në lidhje me presionin e ujit.

Vazhdimësia e furnizimit me ujë

Besueshmëria e shërbimit përfaqëson njërin nga standardet e rëndësishme të shërbimit, e cila paraqet përqindjen e pronave të shërbyera në vazhdimësi me ujë të ndarë në tri kategori: prona që kanë furnizim 24 orë, 18-23 orë furnizim dhe prona që kanë më pak se 18 orë furnizim, duke përjashtuar rastet e veçanta që mund të ndodhin siç janë: ndërprerjet për shkak të problemeve teknike që ndodhin në teren apo ndërprerjeve për shkak të punimeve të planifikuara të Kompanisë.



Fig.3. Norma (%) e konsumatorëve me furnizim të rregullt me ujë të pijshëm

KRU, të cilat kanë raportuar se furnizojnë konsumatorët e tyre 24 orë me ujë të pijshëm janë: KRU 'Gjakova', 'Mitrovica' dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor', por edhe kompanitë tjera nuk qëndrojnë keq sa i përket këtij treguesi duke kaluar vlerën mbi 90% të furnizimit 24 orë me ujë të pijshëm për konsumatorët e tyre, me përjashtim të KRU 'Hidromorava' e cila vetëm 44% të konsumatorëve të saj i furnizon 24 orë me ujë te pijshëm, kryesisht për shkakun

e mungesës së resurseve ujore në Liqenin e Përlepnicës. Viti 2019 ishte një vit me të reshura të pakta që më së shumti ka pasur ndikim në regjionet e furnizimit nga KRU 'Hidromorava', 'Bifurkacioni' dhe 'Prishtina'.

Plasjet e gypave

Ky tregues paraqet numrin total të plasaritjeve të gypave gjatë vitit për 100 km gjatësi të rrjetit të ujësjellësit (duke përjashtuar gypat e shërbimit të kyçjes).



Fig. 4. Numri i defekteve në rrjetin e ujësjellësit për 100 km

Gjatë vitit 2019 numri i defekteve në rrjetin e ujësjellësit për 100 km varijonë nga 484 raste në KRU 'Hidroregjioni Jugor', deri në rastin më të mirë tek KRU 'Hidromorava' me 100 raste në 100 km rrjetë.

Mesatarja e sektorit gjatë vitit 2019 kap vlerën prej 223 raste për 100 km gyp të rrjetit të ujësjellësit. Në raport me vitin 2018 gjatë këtij viti të analizës kemi një trend të rritjes së numrit të rasteve të defekteve në rrjetin e ujësjellësit.

Në performancën e dobët të rrjetit të ujësjellësit ka ndikuar vjetërsia e gypave, mungesa e mirëmbajtjes adekuate nga ana e KRU, si dhe punimet në rrugë nga ana e operatorëve të ndryshëm të cilët jo rrallë herë kanë qenë të pa kujdesshëm ndaj infrastrukturës së ujësjellësit.

Uji i pa faturuar

Një nga sfidat kryesore me të cilat përballen Ofruesit e shërbimeve të ujit në vend është mospërputhja e madhe në mes të sasisë së ujit të prodhuar dhe vendosur në sistemin e shpërndarjes dhe sasisë së ujit të faturuar për konsumatorët. Ky ndryshim njihet si uji i pa faturuar (UPF) dhe përfaqëson mungesën e efikasitetit teknik, financiar dhe menaxherial të ofruesve të shërbimeve. UPF përbëhet nga tre komponentë të humbjeve: humbje komerciale, humbje fizike dhe konsumi i autorizuar por i pa faturuar.



Fig. 5. Norma e UPF (%)

Sasia e UPF gjatë vitit 2019 nga të gjitha kompanitë kap vlerën mbi 87 mil.m ^{3} apo krahasuar me vitin 2018, mbi 3.8 mil.m^3 më pak sasi të ujit të pa-faturuar.

Në nivel sektori norma e UPF ka rënë në 56%, kjo është për 2% më pak se në vitin 2018. Në përjashtim të KRU 'Bifurkacioni', kompanitë e tjera kanë shënuar progres në zvogëlimin e UPF përgjatë këtij viti vlerësues. Edhe përkundër progresit që kanë shënuar kompanitë gjatë këtij viti të analizës, të gjitha KRU pa përjashtim janë larg nivelit të pranueshëm të UPF prej 25%.

KRU 'Bifurkacioni' ka nivelin më të lartë të UPF prej 65%, duke u pasuar pastaj nga KRU 'Hidrodrini' dhe KRU 'Prishtina'. Shifrat e larta të UPF në këto KRU tregojnë se sa pak angazhime janë bërë në vitet e fundit në këtë drejtim.

Sa i përket zvogëlimit të UPF, në pozitë më të mirë qëndron KRU 'Gjakova', ku niveli i humbjeve të ujit ka shënuar trend të rënies vit pas viti dhe aktualisht norma është 43%.

Në figurën e më poshtme janë dhënë statistikat e normave të performancës së realizuar dhe normave projektuese për zvogëlimin e UPF, të cilat ishin të aprovuara nga ARRU për vitin 2019.



Fig.6. Norma (%) e ujit të pa-faturuar (planifikimi-realizimi)-2019

Asnjë nga KRU nuk kanë arritur ti përmbushin objektivat e planifikuara me procesin tarifor. Në rastin më të mirë KRU 'Gjakova' ishte afër arritjes së objektivës në vitin 2019, ku realizimi ishte më i ulët se planifikimi për 1%.

ARRU gjithnjë ka sugjeruar se për të pasur sukses duhet krijuar struktura të qënderueshme brenda kompanisë me: staf profesional, mjete dhe teknologji të avancuara, trajnime të nevojshme, si dhe stimuj financiar për përmbushjen e objektivave, duke marrë parasysh se ballafaqimi me humbjet e ujit do të jetë një punë e vazhdueshme për ofruesit e shërbimeve të ujit.

2.1.2 Performanca jo-financiare (komerciale)

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit

Në vitin 2019 në nivel mesatar rreth 75% e popullatës furnizohen me ujë të pijshëm nga KRU brenda zonave të tyre respektive të shërbimit. Kjo është për 2% më shumë se në vitin 2018. Nga gjithsej 1,238 vend-banime, 584 kanë qasje në sistemet publike të ujësjellësit të menaxhuara nga KRU.



Fig. 7. Norma (%) e mbulueshmerisë së popullatës me shërbime të ujësjellësit

Mbulueshmëria më e madhe me shërbime të ujësjellësit qëndron në KRU 'Gjakova' me normë prej 90%. e cila nëse krahasohet me vitin paraprak 2018 ka shënuar progres për 3%. Progres po ashtu është shënuar edhe tek KRU 'Hidromorava' dhe 'Hidrodrini'.

KRU kanë potencial të mëtutjeshëm të shtrirjes së shërbimeve të ujësjellësit edhe në një numër të konsiderueshëm të zonave rurale, shumica nga të cilat kanë sisteme të ndërtuara dhe janë në pritje të marrjes nën menaxhim nga ana e KRU.

Matja e ujit

Matja e ujit të konsumuar është një prej standardeve të rëndësishme të shërbimit të ujit, është parakusht për një faturim të drejtë duke i ngarkuar konsumatorët në bazë të konsumit të tyre real. Matja e ujit gjithashtu është edhe një mjet i rëndësishëm për kontrollin e konsumit dhe humbjeve të ujit.



Fig.8. Norma(%) e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës

Të gjitha KRU kanë shënuar performancë të mirë tek pajisja e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës gjatë vitit 2019 në raport me vitin paraprak 2018. Ky tregues ka shënuar progres për 1% gjatë vitit 2019 në raport me vitin paraprak 2018. KRU 'Mitrovica' ende qëndron mjaftë ulët në këtë standard shërbimi, ku vetëm 78% e konsumatorëve të saj shtëpiak kanë të vendosur ujëmatës. Përderisa të gjitha kompanitë e tjera kanë një përqindje të lartë të mbulueshmërisë me ujëmatës, megjithëse standardi ligjor i nivelit të shërbimit për matjen e ujit kërkon nga KRU-të që faturimin e të gjithë konsumatorëve të tyre ta bëjnë vetëm përmes ujëmatësve funksional dhe të verifikuar në aspektin e saktësisë.

Në vazhdimësi e sidomos nga viti 2018, ARRU ka kërkuar nga të gjitha ndërmarrjet e ujit të bëjnë matjen e detyrueshme të konsumit të ujit të shpenzuar nga ana e konsumatorëve. Është evidente se asnjëra nga KRU nuk i kanë përmbushur detyrimet e dhëna, ende rreth 4% e konsumatorëve kryesisht në amvisëri faturohen sipas vlerësimit të konsumit. Sidoqoftë, KRU kanë raportuar mbi 12,842 ujëmatës të rinj të instaluar vetëm për

kategorinë e amvisërisë në vitin 2019. ARRU vazhdon t'i monitorojë kompanitë nga afër dhe presim që ato të eleminojnë plotësisht faturimin pa ujëmatës përgjatë vitit 2020.

Ankesat

Numri i ankesave është një tregues i rëndësishëm për vlerësimin e kënaqësharmërisë së konsumatorëve në lidhje me shërbimin e marrë nga ofruesi i tyre i shërbimeve.



Fig. 9. Numri i ankesave për shërbimet e ujësjellësit

Gjatë vitit 2019 numri i ankesave teknike por edhe atyre të natyres komerciale, drejtuar KRU nga ana e konsumatorëve për shërbimet e ujësjellësit ka shënuar rënie për 5,997 ankesa apo (36%) në raport me vitin paraprak 2018.

Janë gjithsej 10,444, ku prej tyre 8,052 janë ankesa të natyrës teknike të lidhura kryesisht me: kualitetin e ujit, presionin, ndërprerjet, si dhe prishjet/rrjedhjet, ndërsa 2,392 janë ankesa komerciale që kanë të bëjnë me: kontestimet e borxheve, gabimet në fatura, ndryshimet e adresave dhe kërkesat tjera të natyrës së njëjtë.

ARRU ende ka rezerva në besueshmërinë e këtyre të dhënave, ku shumica e KRU kanë në përdorim programe të avancuara softverike (CRM, CRS), por mungon përditësimi-azhurnimi i rregulltë dhe saktë i definuar.

KRU-të duhet të mbajnë një regjistër të përditësuar dhe unik të ankesave të konsumatorëve dhe ato ti zgjidhin brenda një afati kohor të përcaktuar me kornizën ligjore.

2.1.3 Performanca financiare

Volumi i ujit të shitur

KRU gjatë procesit tarifor aktual (2018-2020) i kanë paraqitur projeksionet e tyre për volumin e ujit që do të shesin në mënyrë që t'i furnizojnë konsumatorët e tyre. Për vitin 2019 janë planifikuar të faturohen mbi 66 milion m^3 ujë nga të gjitha KRU, përderisa kanë arritur të realizojnë mbi 62 milion m^3, për rreth 4 milion m^3 më pak realizim apo shprehur në përqindje 93%, përjashtuar ujin më shumicë për pjesën veriore.



Fig.10. Normat sasiore për ujin e shitur nga KRU në raport me vlerësimet sipas planit të biznesit

Në nivel sektori shitjet volumetrike të realizuara në raport me ato të planifikuara kanë shënuar performancë në rënie nga 94% sa ishin gjatë vitit 2018 në 93% në vitin 2019. Caku i planifikuar është përmbushur nga KRU 'Mitrovica', 'Gjakova', 'Hidrodrini' dhe KRU 'Prishtina'. Ngecjet në realizimin e planifikimit janë identifikuar tek KRU 'Hidromorava', 'Bifurkacioni' dhe 'Hidroregjioni Jugor', kjo kryesisht për arsyen e mungesës së resurseve ujore, shkaku i thatësisë.

Vlera e shitjeve

Vlera totale e shitjeve të ujit është një tregues i rëndësishëm i performancës financiare përmes të cilës mbulohen shpenzimet operative dhe mirëmbajtja kapitale duke krijuar vetë qëndrueshmërinë financiare.



Fig.11. Vlera e shitjeve të furnizimit me ujë në raport me shitjet e planifikuara

Në vitin 2019 vlera e shitjeve gati në të gjitha KRU ishte më e ulët se sa vlera e planifikuar e shitjeve. Mos realizimi i shitjeve të ujit para së gjithash është rezultat i jo efikasitetit të KRU për ti rritur shitjet sasiore, por një pjesë mund ti atribuohet edhe zvogëlimit të prodhimit, i cili në vitin e shqyrtuar ka qenë më i ulët se sa në vitin paraprak 2018.

Vlera e shitjeve e realizuar për vitin 2019 në nivel të sektorit për furnizim me ujë ishte 30,7 mil.€ ndërsa ajo e planifikuar rreth 33.2 mil.€ që do të thotë së 92.5% e shitjeve janë realizuar nga ajo që ishte planifikuar, dhe është me e ulët për 0.7% krahasuar vitin 2018 që ishte 93.2%.

KRU 'Mitrovica' edhe këtë vit prinë me përqindjen më të lartë të realizimit të shitjeve në raport me kompanitë tjera, duke tejkaluar njëkohësisht cakun e planifikuar prej 7%, përderisa KRU 'Hidromorava' mbetet me përqindjen e realizimit me të ulët prej 77%, me një rënie prej 12% krahasuar me vitin 2018.

Vlera realative e shitjeve



Fig.12. Vlera relative e shitjeve të furnizimit me ujë gjatë 2019 në raport me vitin 2018

Për dallim nga viti i kaluar ku shumica e KRU kishin treguar trende pozitive tek shitjet e furnizimit me ujë, këtë vit vetëm tri prej tyre kanë treguar progres në këtë shërbim.

KRU 'Hidromorava' është kompania e cila ka realizuar shitjet më të ulëta në vitin 2019 me -7.54% në raport me vitin 2018, rezultat i të cilës rënie ka qenë zvogëlimi i ujit të prodhuar në nivelin prej 13% krahas zvogëlimit të shitjeve volumetrike prej 7%.

Në vlerë absolute shitjet në euro në nivel sektori në 2019 janë më të ulëta për -0.44% në raport me vitin 2018 si rezultat i zvogëlimit të tarifës volumetrike për furnizim me ujë në kategorinë e konsumatorëve komercial/institucional, përkundër rritjes se shitjeve volumetrike për 2.3%.

Kostoja për njësi[1] e ujit të prodhuar

Kostoja për njësi e ujit të prodhuar është tregues po ashtu i rëndësishëm financiar në bazë të të cilës kuptojmë shpenzimet për një m3 të ujit të prodhuar.



Fig. 13. Kostoja për njësi e ujit të prodhuar gjatë 2019 në raport me vitin 2018 (Euro/m3 të ujit të prodhuar)

Kostoja mesatare e një njësie uji të prodhuar në 2019 nuk ka pësuar ndonjë ndryshim krahasuar me vitin 2018, pra ka mbetur në nivelin e njëjtë me 0.05 €/m3.

Përderisa në mes të shtatë KRU ekziston një ndryshim i gjerë i kostove të prodhimit, kjo në masë të madhe është e ndikuar nga lloji i furnizimit, varësisht prej asaj se burimi a është sipërfaqësor apo nëntokësor nga mënyra e kaptimit dhe cilësia e ujit të shfrytëzuar.

[1] Kostot për njësi për vitin paraprak 2018 janë të rregulluara për normë të inflacionit 1.027

Mbetet si rast konkret tash e sa vite KRU 'Hidroregjioni Jugor', ku kostoja e lartë e ujit të prodhuar në këtë kompani është ndikuar nga shpenzimet e larta për trajtimin e ujit, në veçanti nga shpenzimet e larta të energjisë dhe derivateve gjatë funksionimit të pompave .

Rënie e lartë e kostos për njësi e ujit të prodhuar për vitin 2019 në raport me vitin e kaluar ishte tek KRU "Gjakova" dhe atë për rreth 50% (nga 0.054 €/m3 sa ishte në vitin 2018 në 0.026 €/m3 për vitin 2019), rezultat i të cilës ishte zvogëlimi shumë i lartë i shpenzimeve të ujit të prodhuar dhe rritjes së shitjeve volumetrike të ujit.

Kostoja totale për njësi e furnizimit me ujë

Përfshinë shpenzimet totale operative dhe shpenzimet për mirëmbajtje kapitale të aktivitetit biznesor për furnizim me ujë, përjashtuar kthimin në kapital dhe borxhet e këqija, të gjitha në raport me volumin e ujit të shitur për të njëjtën periudhë raportuese.



Fig. 14. Kostoja për njësi e furnizimit me ujë (euro për m3 ujë të shitur)

Në vitin 2019 në nivel të sektorit, kostoja për njësi e furnizimit me ujë ka qenë 0.40 €/ m^3 dhe është më e ulët për 0.04 €/m^3, krahasuar me vitin paraprak 2018.

KRU 'Hidrodrini' në raport me kompanitë e tjera ka nivel dukshëm më të ulët të kostos (0.24 €/m^3), duke zvogëluar njëkohësisht koston edhe më shumë krahasuar me vitin paraprak. Përderisa KRU 'Hidroregjioni Jugor' ka koston më të lartë prej 0.47 €/m^3 , e ngritur edhe më tejë nga 0.45 €/m^3 sa ishte në 2018, kryesisht kjo mund ti atribuohet rritjes së shpenzimeve operative duke përfshirë edhe mirëmbajtjen kapitale në nivelin prej 4% dhe zvogëlimit të shitjeve volumetrike.

Përmirësim të lartë të kostos për njësi të furnizimit me ujë e shohim te KRU "Prishtina' nga 0.56 €/m^3 sa ishte në vitin 2018 në 0.47 €/m^3 për vitin aktual, e ndikuar nga rritja e shitjeve volumetrike të ujit dhe zvogëlimi i shpenzimeve operative duke përfshirë mirëmbajtjen.

Kostoja totale për njësi e furnizimit me ujë në raport me planifikimet

Ky tregues paraqet kostot për njësi të furnizimit me ujë të realizuara (shpenzimet operative duke përfshirë edhe mirëmbajtjen kapitale, zbritur për subvencionet e pranuara / shitjet volumetrike) në raport me kostot e planifikuara (shpenzimet operative duke përfshirë edhe mirëmbajtjen kapitale/ shitjet volumetrike).



Fig. 15. Kostoja për njësi e furnizimit me ujë në raport me kostot e planifikuara për njësi

Në nivel të sektorit përmbushja e objektivave të kostove për njësi e furnizimit me ujë në 2019 edhe më tej ka devijuar nga objektiva e planifikuar prej 90%, por krahasuar me vitin paraprak ajo është përmirësuar për 9%, nga 105% në 96%.

Përmbushja e kostove të planifikuara për njësi gati tek të gjitha KRU ishin më të larta se sa ato të planifikuara, në përjashtim të KRU 'Mitrovica', e cila pothuajse është në nivelin më të dëshiruar prej 76%, megjithatë edhe kjo nuk tregon një performancë të mirë, për arsye se kostot e planifikuara për njësi kanë përfshirë shpenzime të konsiderueshme për ripërtëritjen infrastrukturore dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale për asetet e reja (mirëmbajtje kapitale) e që kjo kompani nuk ka arritur ti realizojë as 7% të tyre, madje duke tejkaluar shpenzimet operative të planifikuara .

Performancë më të mirë në këtë tregues në raport më kompanitë e tjera ka arritur ta ketë KRU 'Hidrodrini' me realizimin e kostove për njësi në nivelin prej 87%. Shpenzimet e planifikuara për ripërtëritjen infrastrukturore dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale për asetet e reja kjo kompani ka arritur ti realizojë në nivelin prej 50%, njëkohësisht duke i rritur shitjet volumetrike dhe zvogëluar shpenzimet operative.

Shpenzimet kapitale

Procesi i shikimit tarifor 2018-2020 ka përfshirë provizionime për shpenzime kapitale si për mirëmbajtje ashtu edhe për rritje kapitale. Pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve sidomos e atyre për mirëmbajtje kapitale pritej se do të financoheshin nga burimet vetanake dhe për këtë arsye janë përfshirë në tarifa.

Shpenzimet aktuale kapitale të ndërmarra nga KRU viteve të fundit janë të papërfillshme në krahasim me ato që ishin planifikuar. Një gjë tjetër brengosëse është se gati të gjitha kompanitë në vitin 2019 shpenzimet kapitale ose më mirë të themi në nivelin prej 77% të tyre, i kanë dedikuar në zgjerim të shpenzimeve kapitale dhe pjesën tjetër prej 23% në mirëmbajte kapitale, fakt ky i cili rezulton me përkeqësimin e bazës së aseteve dhe rënie të nivelit të shërbimit.



Fig. 16. Shpenzimet kapitale për furnizim me ujë në raport me planifikimet për vitin 2019

Shpenzimet aktuale në shumicën e KRU, në përjashtim të KRU 'Prishtina', 'Hidrodrini' dhe 'Gjakova', ishin më të ulëta se niveli i pritur dhe atë duke filluar prej 1% të KRU 'Mitrovica' e deri të 28% të KRU 'Bifurkacioni'.

Vlera e investimeve nga të hyrat vetanake për vitin 2019 ka qenë rreth 2,7 mil.Euro, ndërsa nga grantet prej 1,2 mil.Euro.

Në nivel të sektorit për vitin 2019, kompanitë nga të hyrat vetanake kanë planifikuar të shpenzojnë rreth 2.7 mil.€ të cilat edhe janë mbuluar nga tarifat e aprovuara, cak ky i cili është realizuar në nivelin prej 100%.

Tab.2. Vlera e investimeve në shëbimin e ujit

Realizimi i investimeve në shërbimet e ujit nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2019				
Kompania	Inv. në prodhim	Inv.në distribuim	Inv.në aktivitete biznesore	Totali
PR	418,427	610,084	393,754	1,422,265
PZ	226,716	621,763	112,796	961,275
PE	136,608	420,261	196,463	753,332
MIT		26,742	50,320	77,062
GJA	14,402	473,729	36,208	524,339
FE	23,133	4,687	34,938	62,758
GJI	40,287	4,786	3,165	48,238
Totali	**859,573**	**2,162,052**	**827,644**	**3,849,269**

KRU 'Prishtina' prinë me realizimin e shpenzimeve kapitale prej 1.4 mil.euro, prej të cilave pjesa me e madhe e këtyre investimeve janë realizuar në distribuim dhe atë në përtëritje të infrastrukturës siç është: rrjeta/gypat e ujësjellësit, zëvendësimi i ujëmatësve të mëdhenj, pompa zhytëse, punimet në rrjetë për rregullim të presionit, detektor etj. Një pjesë tjerë e investimeve janë bërë edhe në zgjerimin e jo infrastrukturës tek resurset me ndërtimin e rezervarëve dhe me furnizim të kontenjerve të klorit. Me këto shpenzime është synuar të përmirësohet vazhdimësia e furnizimit më ujë, të përmirësohet shërbyeshmëria e infrastrukturës dhe ngritja e nivelit të standardeve të shërbimeve, e për të cilat mund të themi se janë realizuar në nivel pothuajse të dëshiruar.

KRU 'Hidroregjioni Jugor' në raport me kompanitë e tjera mbetet në rendin e dytë për realizim të investimeve në nivelin prej 961,275 €, ku pjesën më të madhe të tyre i ka realizuar në rritje të infrastrukturës në distribuim dhe atë kryesisht në zgjerim të rrjetit në fshatin Mamushë, Carrallukë, Grejkoc.

KRU 'Mitrovica' për vitin 2018 kishte planifikuar investime rreth 7.6 mil. € në projektet e rehabilitimit të rrjetit të ujësjellësit në disa lagje të Vushtrrisë dhe Skenderajt dhe zgjerim të rrjetit në Mitrovicë, por këto projekte janë realizuar vetëm 1% të tyre. Mos realizimi i tyre ishte për shkakun e mos përmbushjes së objektivave të faturimit dhe të arkëtimit, rritjes së shpenzimeve operative, si dhe mos pranimit të donacioneve të planifikuara.

2.2 SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA

2.2.1 Performanca jo-finaciare (teknike)

Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara

Aktualisht shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura në vend është shumë i ulët. Është vetëm një impiant i trajtimit të ujërave të ndotura në Skenderaj i menaxhuar nga KRU 'Mitrovica' dhe disa impiante të vogla në nivel të fshatrave të menaxhuara nga KRU 'Prishtina', nga të cilat kemi mundur të sigurojmë të dhëna adekuate. Pjesa tjetër e ujërave të ndotura të shkarkuara nga KRU nuk arrijnë t'i përmbushin standardet mjedisore.

Ne po shpresojmë që në vitet e ardhshme ky shërbim do të jetë funksional, meqenëse kemi hyrë në një fazë të planifikimeve, investimeve dhe ndërtimeve intensive të impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura. Impiante të tilla me kapacitete të konsiderueshme janë në fazën e ndërtimit në regjionin e Prizrenit, Pejës dhe Gjakovës.

Frekuenca e bllokimit të kanalizimit

Ky tregues paraqet numrin e rasteve të raportuara në lidhje me bllokimet e kanalizimeve të raportuara në periudhën raportuese për 100 km gjatësi të rrjetit të kanalizimit. Një bllokim i kanalizimeve është një bllokim i pjesshëm ose i plotë i një rrjeti apo pusete, që pengon rrjedhën e ujërave të ndotura dhe nuk përfshin bllokime në infrastrukturën brenda pronës së konsumatorëve.



Fig.17. Numri i bllokimeve për 100 km gjatësi të rrjetit

Të gjitha KRU raportuan rritje të nivelit të bllokimeve të sistemit të kanalizimeve për 100 kilometra. Ato në nivel mesatar u rritën nga 304 raste në 2018 në 441 në vitin 2019. Kompania e cila ka raportuar më së shumti të dhëna sa i përket bllokimeve me kanalizim gjatë vitit 2019 është KRU 'Gjakova' me 2,342 raste të bllokimeve për 100 km gjatësi të rrjetit të kanalizimit apo shprehur në përqindje mbi 100% me shumë raste në raport me vitin paraprak 2018. KRU 'Hidrodrini' nga ana tjetër nuk ka raportuar të dhëna, prandaj edhe nuk kemi qenë në gjendje të bëjmë ndonjë vlerësim për këtë kompani në këtë tregues.

Në përgjithësi kompanitë e tjera kanë pak dallime nga njëra tjetra, por pa përjashtim kanë performancë të dobët në këtë tregues. Bllokimi i sistemit të kanalizimeve në vend nuk është i pazakontë, marrë parasysh faktin se një pjesë e sistemit është mjaft e vjetërsuar sa i përket kapacitetit absorbues, mandej pakujdesia e ulët e qytetarëve dhe mungesa e mirëmbajtjes nga ana e kompanive. Faktorë tjetër është fakti se një pjesë e sistemit të kanalizimit është i përbashkët me sistemin e kanalizimit atmosferik dhe ndonjë herë mbetet pa përkujdesjen e duhur nga organet përgjegjëse.

2.2.2 Performanca jo-financiare (komerciale)

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizimi)

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura është e definuar si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit që kanë shërbim të ujërave të ndotura (kanalizim).



Fig.18. Mbulueshmëria e popullatës me shërbime të ujërave të ndotura (%)

Në nivel sektori gjatë vitit 2019, mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura arrin vlerën prej 65%, e cila nëse krahasohet me vitin paraprak 2018 ka shënuar progres për 1%.

KRU 'Prishtina' me 78% ka nivelin më të lartë të mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të ndotura nga të gjitha kompanitë e tjera.

Në përgjithësi të gjitha KRU nëse i krahasojmë me vitin paraprak pothuajse janë në pozicion të njëjtë, me lëvizje simbolike sa i përket progresit.

Ankesat

Numri i ankesave është një tregues i rëndësishëm për vlerësimin se sa janë të kënaqur konsumatorët në lidhje me shërbimin e marrë nga ofruesi i tyre i shërbimeve.



Fig.19. Numri i ankesave për shërbimin e ujërave të ndotura

Në total gjatë vitit 2019 numri i ankesave për shërbimet e ujërave të ndotura arrin vlerën 2,888 prej të cilave 2,841 kanë të bëjnë me aspektet teknike ndërsa 47 me aspektin komercial.

Gjatë vitit 2019 numri i ankesave si i atyre teknike edhe atyre komerciale për shërbimet e ujërave të ndotura kanë shënuar rënie për 1,763 ankesa më pak krahasuar me vitin paraprak 2018, apo shprehur në përqindje për 38%.

Numri më i madh i ankesave gjatë vitit 2019 për shërbimin e ujërave të ndotura është paraqitur nga KRU 'Hidrodrini' me gjithsej 1,569 ankesa, ndërsa kompania e cila nuk ka prezantuar fare ankesa në shërbimet e ujërave të ndotura është KRU 'Mitrovica'.

Ankesat në këtë shërbim kryesisht kanë qenë në lidhje me bllokimet e kanalizimeve, rastet e përmbytjeve dhe kërkesave për pastrim të kanalizimit. Siç vërehet edhe nga figura më lartë konsumatorët janë ankuar më pak për çështjet komerciale në shërbimin e ujërave të ndotura.

2.2.3 Performanca financiare

Vlera e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura

Figura 20 si me poshtë paraqet performancën e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura në raport me vlerësimet e planifikuara ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU për procesin e rishikimit tarifor - 2019.



Fig. 20. Vlera e shitjeve të ujërave të ndotura në raport me planifikimet

Gati të gjitha KRU-të nuk kanë mundur të arrijnë objektivat e shitjeve të ujërave të ndotura gjatë vitit 2019 në përjashtim të KRU 'Hidrodrini' dhe 'Mitrovica', të cilat madje i kanë tejkaluar objektivat e planifikuara për 18% (Hidrodrini), dhe 7% (Mitrovica).

Në nivel të sektorit në vitin 2019 vlera e shitjeve të realizuara për shërbimet e ujërave të ndotura ishte 4,549,732 € ndërsa ajo e planifikuar 5,064,303€, kjo do të thotë së 90% e shitjeve janë realizuar nga ajo që ishte planifikuar dhe është më e ulët për 5% krahasuar me vitin 2018 kur ajo ishte 95%.

Performanca jo e mirë e shitjeve aktuale të ujit, krahasuar me shitjet e planifikuara, ka ndikuar që edhe shitjet aktuale në shërbimet e ujërave të ndotura në nivel të sektorit të jenë nën nivelin e vlerës së planifikuar.

Vlera relative e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura



Fig. 21. Vlera e shitjeve të shërbimit me ujëra të ndotura gjatë vitit 2019 në raport me vitin 2018

Trendi i vlerës së shitjeve të realizuara për shërbimet e ujërave të ndotura gjatë periudhës raportuese 2019 në raport me vitin 2018, në nivel sektori ka qenë pozitiv, rritja ishte prej 7.56% në raport me vitin e kaluar.

KRU 'Hidroregjioni Jugor' edhe këtë vit mbetet kompania me realizimin më të lartë të shitjeve të shërbimit të ujërave të ndotura në raport me vitin e kaluar dhe atë me 70% rritje, përderisa kjo kompani tek shërbimet e furnizimit me ujë kishte treguar trend negativ. Rezultat i kësaj ngritje ka qenë kryesisht tarifa për trajtimin e ujërave të ndotura e aplikuar nga 1 Janari i vitit 2019 deri tek muaji Tetor i po këtij viti, tek të gjithë konsumatorët që marrin shërbime të ujërave të ndotura.

Edhe tek shërbimi i ujërave të ndotura KRU 'Hidromorava' është kompania e cila ka realizuar shitjet më të ulëta në vitin 2019 me -13.2% në raport me vitin 2018, rezultat i të cilës ka qenë zvogëlimi i shitjeve volumetrike të ujit duke reflektuar njëkohësisht edhe në zvogëlimin e shitjeve volumetrike të ujërave të ndotura, si pasojë e mungesës së reshjeve atmosferike dhe rënies së nivelit të ujit nën gjendjen e rëndomtë .

Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura[2]

Kostot për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura janë të definuara si kosto vjetore për konsumatorët shtëpiak të shërbyer[3].



Fig. 22. Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura (operative+mirëmbajtje kapitale)

2 Kostoja për njësi e vitit 2018 është e rregulluar për normën të inflacionit 1.027 dhe ndryshon nga kostoja e paraqitur në Raportin paraprak.

3 Konsumatorët shtëpiak të shërbyer definohen si numri aktual i konsumatorëve shtëpiak plus numri i konsumatoreve jo shtëpiak të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiak bazuar në ndarjen proporcionale të ujit të konsumuar.

Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura në nivel të sektorit në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 ka qenë me e ulët për 0.9 €/m3 ose 12%.

Në vitin 2018 në tri nga shtatë kompanitë është shënuar rënie e kostove për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura, rezultat i të cilave rënie ka qenë ngritja e numrit të konsumatorëve shtëpiak të shërbyer, përkundër rritjeve të shpenzimeve totale për ujëra të ndotura në shumë nga këto kompani.

Koston më të ulët në këtë tregues, njëkohësisht edhe përmirësimin më të lartë për vitin 2019 e ka KRU 'Prishtina', me 1.94 €/kons. me një rënie prej 4.14 €/kons. krahasuar me vitin paraprak, përderisa koston më të lartë për vitin 2019 në raport me vitin 2018 e ka KRU 'Hidroregjioni Jugor', me një rritje gjithashtu nga viti paraprak prej 3.62 €/m3 ose 31%, rezultat i të cilës kanë qenë shpenzimet e larta operative, përkundër rritjes së numrit të konsumatorëve.

Kostoja totale për njësi e shërbimeve të ujrave të ndotura në raport me planifikimet

Kostoja totale për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura është një tregues po ashtu i rëndësishëm financiar i cili radhitet në grupin e treguesve kryesor në bazë të të cilit matet performanca e ujërave të ndotura. Treguesi i paraqitur grafikisht si më poshtë paraqet raportin në mes kostos për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura të realizuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/me ekuivalentet e konsumatorëve shtëpiak[4]) dhe kostos për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura të planifikuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/ ekuivalentet e konsumatorëve shtëpiak).



Fig. 23. Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura në raport me kostot e planifikuara për njësi (%)

Përmbushja e kostove të planifikuara për njësi që rrjedhin nga rishikimi tarifor 4 (2018-2020) konkretisht për vitin 2019 (të rregulluara sipas niveleve të çmimeve në 2017), në të gjitha KRU ishin më të ulëta se sa ato të planifikuara.

Edhe pse kompanitë kanë arritur pothuajse nivelin e dëshiruar më të ulët se 90%, prapë këto kompani nuk kanë treguar performancë të mirë, për arsye së shumica prej tyre kanë tejkaluar shpenzimet operative, përderisa shpenzimet për mirëmbajtje kapitale nuk ka arritur as 9% të tyre ti realizojnë.

Shpenzimet kapitale për ujëra të ndotura

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale të realizuara për mirëmbajtje dhe rritje kapitale në shërbimet e ujërave të ndotura në raport me shpenzimet kapitale të aprovuara në planin e biznesit.

[4] Konsumatorët shtëpiak të shërbyer definohen si numri aktual i konsumatorëve shtëpiak plus numri i konsumatoreve jo shtëpiak të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiak bazuar në ndarjen proporcionale të ujit të konsumuar.



Fig. 24. Shpenzimet kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura në raport me planifikimet-2019

Kompanitë për vitin 2018, kishin paraparë provizionime të konsiderueshme (14.1mil. €), për rritje kapitale dhe mirëmbajtje kapitale në shërbimet e ujërave të ndotura, të parapara të sigurohen si nga mjetet vetanake ashtu edhe nga donacionet, por në realitet shpenzimet aktuale ishin shumë më të ulëta se niveli i pritur, dhe atë prej 109,437€ ose 1% nga ato që ishin planifikuar gjatë procesit tarifor 2018-2020 (konkretisht viti 2019).

Për vitin 2019 kompanitë nga të hyrat vetanake kanë planifikuar të shpenzojnë rreth 1.1 mil.€, por që këto shpenzime kanë arritur të mbulohen vetëm 9%.

Sa i përket investimeve të realizuara në shërbimet e ujërave të ndotura në raport me planifikimet prinë KRU 'Bifurkacioni' me 15%, të cilat kryesisht kanë qenë të orientuara në mirëmbajtje dhe zgjerim të aseteve jo infrastrukturore (Aktivitet Biznesor).

Tab. 3. Vlera e investimeve në shërbimin e ujërave të ndotura

Realizimi i investimeve në shërbimet e ujërave të ndotura nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2019					
KRU	Inv.në grumbullim	Inv.në trajtim	inv.në shkarkim	inv.akt. biznesore	Totali
PR	1,350	0	0	12,178	13,528
PZ	0	0	0	16,557	16,557
PE	33,195	0	0	20,844	54,039
MIT	0	0	0	5,591	5,591
GJA	6,206	0	0	1,906	8,112
FE	1,195	0	0	10,167	11,362
GJI	0	0	0	248	248
Totali	**41,946**	**0**	**0**	**67,491**	**109,437**

Për dallim nga shërbimet e ujësjellësit ku printe KRU 'Prishtina', në shërbimin e ujërave të ndotura prinë KRU 'Hidrodrini' me realizimin e investimeve prej 49% të shumës totale të investimeve dhe e cila përqindje është realizuar kryesisht në përtëritje të infrastrukturës për grumbullimin e ujërave të ndotura.

KRU 'Hidroregjioni Jugor', 'Gjakova' dhe 'Hidromorava' janë kompanitë që kanë planifikuar shpenzime domethënëse kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura: në rritje dhe rehabilitim të rrjetit, në ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura, montimi dhe sigurimi i kapakëve për puseta të kanalizimit fekal, ndërtimin e kolektorëve kryesor për grumbullimin e ujërave të ndotura etj, e që realisht këto kompani nuk kanë arritur as 1% të tyre ti realizojnë.

Është dëshpëruese se edhe përkundër kërkesave të mëdha për investime kapitale të cilat i ka ky shërbim, shumat e buxhetuara si nga KRU ashtu edhe nga Agjencionet zhvillimore në vend, vazhdojnë të jenë shumë minore.

2.3 PERFORMANCA E PËRGJITHSHME FINANCIARE E KRU

2.3.1 Arkëtimi i të ardhurave

Ky është njëri prej treguesve më domethënës i cili krahas efiçencës së faturimit dhe reduktimit të humbjeve të ujit, ka impakte të drejtpërdrejta në qëndrueshmërinë financiare të kompanisë.



Fig.25. Efiçenca në arkëtimin e të ardhurave/faturimin (përjashtuar të ardhurat e tjera operative)

Në vitin 2019 gati të gjitha kompanitë kanë arritur të kenë përmirësim të efiçencës së arkëtimit, përjashtuar KRU 'Prishtina' dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor' të cilat në raport me vitin paraprak kanë treguar performancë më të dobët.

Progresin më të lartë në shkallën e arkëtimit e ka arritur KRU 'Bifurkacioni' me një ngritje prej 8% krahasuar me vitin paraprak, megjithatë nuk mund të themi se ka treguar performancë të mirë, pasi që kompania ka zvogëluar shitjet në vlerë monetare dhe arkëtimin e të hyrave të faturuara e ka mbajtur në nivel të njejtë me vitin 2018.

Shkalla e arkëtimit për faturat e shërbimit të ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura si mesatare e sektorit për vitin 2019 ishte 93% dhe është për 2% më e lartë se sa në vitin 2018.

Objektiva e përcaktuar me proceset rregullatore (tarifore) për vitin 2019 në nivel të sektorit ka qenë 88%, përderisa ky cak aktualisht në nivel të sektorit ka arrit të tejkalohet për 3%. Në vitin 2019 të gjitha kompanitë kanë arrit planifikimet e tyre madje shumica prej tyre i kanë tejkaluar ato, si KRU 'Gjakova' dhe 'Hidrodrini' me nga 8%, KRU 'Hidroregjioni Jugor' 4%, KRU 'Hidromorava', 'Prishtina' dhe KRU 'Mitrovica' me nga 1%, përderisa në nivelin e njëjtë më atë të planifikuar mbetet KRU 'Bifurkacioni' me 88%.



Fig. 26. Inkasimi i realizuar/inkasimi i panifikuar për vitin 2019

Efiçenca e lartë e arkëtimit të realizuar në raport me planifikimet i përket në përgjithësi pagesave të faturave nga konsumatorët të institucioneve, por edhe një pjesë e konsumatorëve shtëpiak nga të cilat kompanitë nuk mund të mbledhin keshin e faturuar.

Këtë vit KRU 'Gjakova' mban rekordin me 99% të arkëtimit në amvisëri, përderisa KRU 'Hidromorava' kryeson me normën më të lartë të arkëtimit në kategorinë e bizneseve me 114% dhe në kategorinë e konsumatorëve institucional me 107%.

Në KRU 'Mitrovica' konsumatorët e amvisërisë mbesin paguesit më të dobët të borxheve. Vetëm 70% të tyre arrijnë ti shlyejnë borxhin për shërbimin e ofruar nga ofruesi i tyre i shërbimeve, edhe pse krahasuar me vitin paraprak kanë pasur rritje prej 10%.

Një përmirësim i mëtejmë i efiçencës së arkëtimit kërkon angazhim permanent dhe të vazhdueshëm përmes zhvillimit të planeve të qëndrueshme të veprimit, përmirësimin e leximit të rregullt të ujëmatësve, faturim të rregullt, si dhe ndërmarrjen e masave operative dhe ligjore me kohë për konsumatorët e pandërgjegjshëm.

2.3.2 Kthimi në kapital

Kthimi në kapital si kusht i domosdoshëm për të arritur një nivel huamarrës të mjaftueshëm për të tërhequr investime shumë të nevojshme për sektorin, është fut në përdorim në procesin tarifor (2009-2011) dhe ka vazhduar në vitet deri me tani.

Për rishikimin tarifor 2018-2020, ARRU ka propozuar një normë të vërtet të kthimit (pas inflacionit) prej 4% në bazën rregullatore të aseteve (BRRA)5, pra një normë reale të kthimit në kapital e cila është e bazuar në praktikat e mira të vendeve të Evropës Perëndimore.



Fig. 27. Kthimi në bazën rregullatore të aseteve (BRRA)

Kthimi në kapital në nivel të sektorit ka treguar trend pozitiv krahasuar me vitin paraprak dhe atë për 4.48% nga 0.34% sa ishte në vitin 2018, në 4.82% për vitin 2019.

Këtë vit të gjitha kompanitë kanë arritur të kenë kthime pozitive, madje shumica prej tyre kanë tejkaluar nivelin e planifikuar prej 4%, që do të thotë se kanë arritur ti mbajnë shpenzimet e tyre, përfshirë zhvlerësimin sipas kostos aktuale dhe mirëmbajtjen infrastrukturore në BRRA brenda kufijve të të ardhurave të tyre.

KRU 'Mitrovica, edhe pse ende mbetet në nivelin më të ulët të kthimit në kapital, krahasuar me vitin e kaluar prinë me përmirësimin më të lartë dhe atë prej 10.73% nga -10.46 sa ishte në vitin 2018 në 0.28% për vitin 2019. Ky ndryshim kaq i lartë i dedikohet ngritjes së lehtë të të hyrave operative dhe kryesisht subvencionit të cilin e ka pranuar kjo kompani, përkundër ngritjes së shpenzimeve operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale.

[5] Për detaje te mëtejshme mbi bazën rregullatore të aseteve (se si është definuar dhe e përcaktuar) URRK- të ARRU.

2.4 PERFORMANCA E PËRGJITHSHME E KRU

Në këtë të pjesë të raportit është vlerësuar performanca e përgjithshme për të dy sektoret (furnizimi me ujë dhe shërbimi i ujërave të ndotura) mbi bazën e cilësisë, niveleve të shërbimit, mbulueshmërisë dhe efiçencës së kostos. Këto pastaj janë kombinuar dhe i është shtuar efiçenca komerciale dhe financiare (arkëtimi i të ardhurave dhe kthimi në BRRA) për të arritur në një matje të përgjithshme të performancës së KRU.

Kriteret e matjes së performancës së shërbimit të furnizimit me ujë dhe shërbimit të ujërave të ndotura, janë të tilla që një rezultat 100% pasqyron sigurimin e nivelit të shërbimit e krahasuar me një perfomancë moderne të shërbimeve efikase dhe funksionale të shërbimit/furnizimit me ujë.

Duke pasur parasysh se ARRU në vazhdimësi ka synuar avancimin e procesit të monitorimit të performancës, pas një analize dhe vlerësimi të tërë procesit me qëllim të zhvillimit dhe zbatimit të një kuadri edhe më efektiv monitorues për vitin 2019 ka ndryshuar një pjesë të PMV, gjegjësisht skemës së TKP i janë shtuar dy tregues reprezentativ: mbulueshmëria me shërbime të trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve me interes të drejtpërdrejtë në kënaqshmërinë e konsumatorit.

Po ashtu kemi ndryshuar metoden e kalkulimit të mbulueshmërisë me shërbime, me qëllim të pasqyrimit të këtij treguesi në aspektin e shtrirjes gjeografike të mbulimit. Tani mbulushmëria me shërbime e popullatës do të vlerësohet vendbanim pas vendbanimi në ato zona ku ata jetojnë. Në këtë rast disa nga treguesit të cilët kanë pasur peshë të vlerësimit me të madhe ju është zvogëluar pesha. Të furnizimi me ujë kemi zvogëluar peshën e cilësisë së ujit për 5% përderisa kemi rritur peshën e treguesit të UPF po me të njëjtën vlerë me 5%. Në shërbimin e ujërave të ndotura, treguesi i mbulueshmërisë me shërbime është ndarë në dy pjesë: Mbulueshmëria me shërbime të trajtimit të ujërave të ndotura i është dhënë një peshë prej 20%, për të reflektuar fokusin në nevojën e zhvillimit të këtij si tregues i rëndësishëm mjedisor. Treguesit të trajtimit të ankesave i është dhënë peshë me vlerë prej 5%, meqenëse e kemi vlerësuar si aspekt me interes të drejtpërdrejtë në kënaqeshmërinë e konsumatorëve. Në bazë të analizave tona, ndryshimet e bëra në skemën e TKP, kanë pas impakt të konsiderueshëm në rezultatin e përgjithshëm dhe rangimin përfundimtar të KRU në vitin 2019 dhe duke marrë në konsideratë këto fakte, gjatë vlerësimit të performancës së përgjithshme në këtë raport do të kufizohemi vetëm në vlerësimin e performancës së përgjithshme për vitin 2019, pa bërë krahasime për progresin nga viti 2018. Tani janë 15 (pesëmbëdhjetë) tregues kryesorë të performancës së bashku me peshat e tyre të lidhura me: standardet e shërbimit, performancën financiare dhe operative dhe kualitetin e të dhënave (besueshmëri), siç tregohet në skemën e TKP.

Tab. 4 Struktura e matjes së performancës (TKP dhe pesha e tyre)

Grupi	**Njësia matëse e performancës**	**Koeficienti i nën-grupit**		**Koeficienti i Grupit**	
Ujë	Cilësia e ujit të pijshëm	20%	100%	45%	100%
	Presioni	5%			
	Disponueshmëria	20%			
	Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit	20%			
	Efiçenca e kostos	10%			
	Uji i pa-faturuar	25%			
Ujëra të ndotura	Cilësia e shkarkimeve	10%	100%	30%	
	Besueshmëria	30%			
	Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të	30%			

	ndotura-kanalizimit				
	Mbulueshmëria me shërbime të trajtimit të ujërave të ndotura	20%			
	Efiçenca e kostos	10%			
Të përgjithshme-financiar dhe jo-financiar	Ankesat e trajtuar me kohë	5%			
	Pikët (besueshmëria) e përcaktuara prej Auditimit	5%			
	Profitabiliteti	5%			
	Efiçenca komerciale	10%			

2.4.1 Performanca e përgjithshme - shërbimi me ujësjellës

Performanca e përgjithshme e furnizimit me ujësjellës analizon dhe vlerëson performancën e përgjithshme të KRU-ve duke marrë në konsideratë përpjekjet individuale të tyre në përmirësimin e TKP si: mbulueshmëria me shërbime, cilësia e ujit të furnizuar, presioni i ujit, vazhdimësia e furnizimit, uji i pa-faturuar, si dhe efiçenca e kostos.

Rezultati total i performancës së një kompanie është llogaritur si një shumë e rezultatit të performancës për secilin tregues i kalkuluar në bazë të kritereve dhe metodologjisë së përcaktuar në PMV dhe ndryshimeve të fundit.

Mesatarja e përgjithshme e furnizimit me ujësjellës në vitin 2019, ka arritur nivelin 33.59% nga niveli i synuar ideal prej 45%.



Fig. 28. Rezultatet e vlerësimit të performancës së furnizimit me ujësjellës si dhe rangimi i KRU(2019)

Nga analiza e rezultateve mund të konstatojmë se KRU 'Gjakova' me 36.63%, është ranguar e para me performancën më të mirë në furnizimin me ujësjellës, pasuar nga KRU 'Hidrodrini' me 32.13% dhe KRU 'Prishtina' me 32.12%, përderisa përformanca më e dobët është treguar në KRU 'Hidromorava' dhe KRU 'Bifurkacioni'.

KRU 'Gjakova' shumicën e treguesve i ka përmbushur në nivelin e objektivave të idealës, përjashtuar treguesin e UPF dhe efiçencën e kostos. UPF dhe efiçenca e kostos janë dy nga treguesit të cilëve kjo kompani duhet përkushtuar vëmendje për të fituar përmirësim të mëtejshëm. Aktualisht performanca e KRU 'Gjakova' është në nivelin 36.63% nga caku prej 45%.

Tab. 5. Rezultatet për performancën e përgjithshme të furnizimit me ujësjellës në vitin 2019

KRU	Cilësia e Ujit	Presioni	V. Furnizimit	Mbulueshmëria	UPF	Efiç.e kostove	Totali
Ideal	**20.0%**	**5.0%**	**20.0%**	**20.0%**	**25.0%**	**10.0%**	**45%**
GJA	20.0%	5.0%	20.0%	18.0%	12.3%	6.1%	36.63%
PE	19.9%	5.0%	19.9%	16.6%	0.0%	10.0%	32.13%
PR	20.0%	5.0%	19.6%	16.2%	1.3%	9.3%	32.12%
MIT	19.8%	5.0%	20.0%	14.2%	3.2%	5.0%	30.27%
PZ	20.0%	5.0%	20.0%	12.6%	2.9%	5.6%	29.73%
FE	19.7%	5.0%	18.7%	15.0%	0.0%	6.7%	29.29%
GJI	19.1%	4.5%	10.5%	12.0%	7.5%	8.9%	28.12%
Sektori	**19.9%**	**5.0%**	**19.7%**	**16.1%**	**6.4%**	**7.5%**	**33.59%**

Në tre prej treguesve si: cilësia e ujit, presioni i ujit, vazhdimësinë e furnizimit gati të gjitha KRU kanë arritur kufirin e përmbushjes së objektivave në vitin 2019. Nga ky rast duhet përjashtuar KRU 'Hidromorava' dhe KRU 'Bifurkacioni' të cilat kanë dështuar për të ofruar furnizim 24 orë, si dhe dështime në cilësinë e ujit si rezultat i aplikimeve të reduktimeve të ujit.

Treguesit me sfidues në këtë shërbim, ende mbetën: reduktimi i UPF, zgjerimi i mbulimit me shërbime dhe efiçenca e kostos. Prandaj pa përjashtim të gjitha KRU, programin e tyre të investimeve, duhet orientuar në projeksione për të shënuar rezultate në këta tregues kyç të furnizimit me ujë.

2.4.2 Performanca e përgjithshme – shërbimi me ujëra të ndotura

Performanca e përgjithshme e shërbimeve të ujërave të ndotura, merr në konsideratë analizën dhe vlerësimin e arritjeve në TKP në këtë shërbim si: mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura, mbulueshmëria me trajtim të ujërave të ndotura, cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara si dhe besueshmëria e rrjetit të kanalizimit.

Vlerësimi i performancës së përgjithshme të shtatë KRU në shërbimin me ujërave të ndotura, bazohet po ashtu në vlerësimin krahasues në lidhje me nivelin 'ideal' të performancës së pritshme të kompanisë që funksionon mirë dhe ofron shërbime efiçente të ujërave të ndotura.

Performanca e përgjithshme e shërbimit të ujërave të ndotura në mesatare të vitin 2019, në raport me nivelin e përgjithshëm ideal të synuar prej 30%, ka arritur nivelin prej 7.1% , kjo është shumë e ulët në krahasim me nivelin e synuar prej 30%, të ndarë për këtë shërbim nga performanca e përgjithshme.

Performancën më të mirë në shërbimin e ujërave të ndotura e ka realizuar KRU 'Bifurkacioni', me totalin e pikëve 8.3%, nga maksimalja prej 30%. KRU 'Mitrovica', 'Hidrodrini', 'Hidromorava' dhe 'Hidroregjioni Jugor' kanë performancë dukshëm më të ulët se mesatarja në këtë shërbim.



Fig.29. Performanca e përgjithshme e shërbimeve të ujërave të ndotura -2019

Vlerësimi i performancës së përgjithshme për shërbimet e ujërave të ndotura edhe këtë vit është bërë në bazë të vetëm dy tregueseve (mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të ndotura dhe efiçenca e kostos). Dy treguesit e tjerë (mbulueshmëria me trajtim të ujërave të ndotura dhe cilësia e shkarkimit) të ndërlidhura me trajtimin e ujërave të ndotura, nuk janë vlerësuar edhe këtë vit, për shkak se aktualisht trajtimi i ujërave të ndotura është i kufizuar, si dhe mungojnë të dhënat mbi cilësinë dhe standardet e ujit. Për më tepër në bazë të dakordimit pas konsultimit me ofruesit e shërbimeve, ARRU ka marrë vendim që : treguesi i mbulueshmërisë me shërbime të trajtimit të ujërave të ndotura do të hyn në vlerësim pasi të gjitha KRU do të marrin në menaxhim ITUN, në zonat e tyre respektive të shërbimit.

Tab. 6. Rezultatet për performancën e përgjithshme në shërbimin e ujërave të ndotura në vitin 2019

KRU	Cilësia e shkarkimeve	Besueshmëria	Mbulueshmëria me ujëra të ndotura	Mbulueshmëria ITUN	Efiç. e kost	Totali
Ideal	**10%**	**30%**	**30%**	**20%**	**10%**	**30%**
FE	0.0%	0.0%	22.2%	0.0%	5.4%	8.3%
GJA	0.0%	0.0%	20.1%	0.0%	6.8%	8.1%
PR	0.0%	0.0%	23.4%	0.0%	2.8%	7.9%
PZ	0.0%	0.0%	18.6%	0.0%	3.0%	6.5%
GJI	0.0%	0.0%	14.7%	0.0%	6.7%	6.4%
PE	0.0%	0.0%	13.5%	0.0%	7.7%	6.4%
MIT	0.0%	0.0%	18.0%	0.0%	2.7%	6.2%
Sektori	**0.0%**	**0.0%**	**18.6%**	**0.0%**	**5.0%**	**7.1%**

Mbulimi me shërbime të ujërave të ndotura, nuk është zhvilluar ende në nivelin e dëshiruar, në pozicionin më të mirë janë KRU 'Prishtina' dhe 'Bifurkacioni', përderisa KRU 'Hidrodrini' mbetet me nivelin më të ulët të shtrirjes me shërbime të ujërave të ndotura në regjionin e vetë të përgjegjësisë.

Efiçenca e kostos në shërbimin e ujërave të ndotura gjendet në nivelin prej 5% për vitin 2019, dhe pa përjashtim në të gjitha KRU kjo tregon efiçencë më të ulët se sa ishte planifikuar. Performancë më të mirë në këtë tregues ka shënuar KRU 'Hidrodrini', 'Gjakova' dhe 'Hidromorava', përderisa një nivel shumë të ulët të efiçencës së kostos ka treguar KRU 'Mitrovica' dhe 'Prishtina'.

Në mënyrë të ngjashme, pasi që besueshmëria për të gjitha KRU (e matur mbi bazën e vërshimeve / bllokimeve për 100 km gyp në vit) është më e lartë se maksimalja absolute prej 100 nga niveli ideal, asnjë nga KRU nuk kanë mundur të sigurojnë ndonjë pikë. Kjo d.m.th se në këtë tregues performanca e të gjitha kompanive është e dobët.

Nga diagrami i performancës dhe tabela e statistikave mund të konkludojmë se shërbimi i ujërave të ndotura është shumë dobët i zhvilluar në raport me furnizimin me ujë dhe ka nevojë për investime të konsiderueshme në përmirësimin e mbulueshmërisë me shërbime dhe ndërtimin e objekteve për trajtim të ujërave të ndotura, pa të cilat do të ishte e pamundur për KRU që të arrijnë përmirësime të prekshme në ofrimin e këtyre shërbimeve .

2.4.3 Performanca e përgjithshme e KRU

Në vazhdim është dhënë performanca e përgjithshme e KRU për të dy shërbimet, atë të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të ndotura, duke u kombinuar me performancën financiare (profitabilitetin dhe efiçencën komerciale), ankesat si dhe raportimin rregullator.

Performanca mesatare e sektorit në vitin 2019, është në nivelin prej 59.26%, nevojitet përmirësim i përgjithshëm edhe për 40.74%, për të arritur maksimalen prej 100% (performancën ideale).



Fig. 30. Performanca e përgjithshme e KRU në 2019

Në tabelën 7 është pasqyruar rangimi i KRU-ve sipas performancës se tyre për vitin 2019 në raport me kompaninë Ideale.

Bazuar në kriteret e përgjithshme të rangimit, KRU 'Gjakova' ka siguruar një performancë më të mirë nga të gjitha KRU e tjera, me nivelin aktual prej 69.22% nga maksimalja prej 100%.

KRU 'Prishtina' rangohet si kompania e dytë me performancën e përgjithshme prej 63.56%. Nga ana tjetër, KRU 'Mitrovica' me 50.57%, pasuar nga 'Bifurkacioni' me 53.79% dhe 'Hidromorava' me 57.15%, kanë performancë dukshëm më të ulët se mesatarja e performancës së përgjithshme të KRU-ve.

Tab. 7. Rezultatet për performancën e përgjithshme të KRU në vitin 2019

KRU	Furnizim me ujë	Ujëra të ndotura	Profitabiliteti	Arkëtimi	Ankesat	Raportimi rregullator	Total i Pikëve
Ideal	**45.0%**	**30.0%**	**5.0%**	**10.0%**	**5.0%**	**5.0%**	100.0%
GJA	36.6%	8.1%	5.0%	9.6%	5.0%	4.9%	69.22%
PR	32.1%	7.9%	5.0%	8.7%	5.0%	4.9%	63.56%
PE	32.1%	6.4%	5.0%	8.6%	4.8%	4.3%	61.16%
PZ	29.7%	6.5%	4.9%	8.7%	5.0%	4.6%	59.41%
GJI	28.1%	6.4%	5.0%	7.8%	4.9%	4.9%	57.15%
FE	29.3%	8.3%	0.9%	6.9%	4.9%	3.5%	53.79%
MIT	30.3%	6.2%	0.3%	4.5%	5.0%	4.2%	50.57%
Total	**31.2%**	**7.1%**	**3.7%**	**7.8%**	**4.9%**	**4.5%**	**59.26%**

Pa përjashtim, KRU janë duke operuar në nivele shumë më të ulëta se çfarë do të konsiderohej një nivel ideal i shërbimit. Arsyet kryesore që ndikojnë në performancën e përgjithshme janë: në përgjithësi shërbimi i ujërave të ndotura dhe mungesa e trajtimit, uji i pa faturuar tek shërbimi i furnizimit me ujë, si dhe efiçenca komerciale (arkëtimi dhe profitabiliteti).

Ne po ashtu jemi të bindur se për shumicën nga përmirësimet e nevojshme kërkohen nivele të konsiderueshme të investimeve. Megjithatë për të siguruar investime të tilla, KRU duhet të demonstrojnë aftësitë e tyre për të maksimizuar efiçencën në ato zona që ato janë nën kontroll të drejtpërdrejtë të tyre, në veçanti në efiçencën e arkëtimit të të ardhurave dhe efiçencën e kostove dhe operative.

ARRU do të angazhohet edhe me tejë në sigurimin që tarifat e përcaktuara të jenë të mjaftueshme për të financuar planet e investimeve të nevojshme për KRU, për të arritur nivelin e tyre të objektivave të shërbimit dhe për të garantuar që KRU në të vërtetë ndërmarrin aktivitetet e investimeve të lejuara gjatë rishikimit të tarifave.

3. PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT MË SHUMICË

ARRU është përgjegjës për rregullimin e pjesës se afarizmit të NHE 'Ibër Lepenci', e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina'.

Në vazhdim, po i japim disa të dhëna statistikore dhe disa tregues të performancës për të parë trendët e zhvillimit të performancës në vitin 2019, në raport me vitin 2018.

Tab. 8. Të dhënat statistikore për NHE 'Ibër-Lepenc'

Të dhënat statistikore për 2019 / 2018	**2018**	**2019**
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m3)	44,548,630	48,917,200
Faturimi për ujin më shumicë (€)	1,052,904	1,210,418
Arkëtimi për ujin më shumicë (€)	1,204,344	1,232,953
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit më shumicë (€)	1,286,328	1,359,052
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit më shumicë	69	69

Në vitin 2019 siç edhe vërehet nga tabela më lartë, shitjet e ujit në vlerë sasiore për KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina' janë ngritur në nivelin prej 4.4 mil. m3 ose 10% në raport me vitin 2018, e cila rritje pastaj ka ndikuar që edhe shitjet e ujit në vlerë monetare të rriten për 15%.

Po ashtu, si rezultat i rritjes së shitjeve në vlerë sasiore janë rritur edhe shpenzimet për furnizimin e ujit me shumicë në nivelin prej 6%.

Tab. 9. Treguesit e Performancës se NHE 'Ibër-Lepenci'

Treguesi i performancës	**2018**	**2019**
Shkalla e arkëtimit	114%	102%
Norma e punës	0.82	0.89
Norma e mbulimit të punës	0.94	0.91
Kostoja e operimit për njësi (€/m3)	0.03	0.03

Në tabelën 9 është dhënë një pasqyrë e treguesve financiar në bazë të të cilëve mund të vlerësohet performanca e NHE 'Ibër Lepenci' gjatë vitit 2019/2018.

Shkalla e arkëtimit për vitin 2019 është 102%, edhe pse ka pas rënie nga viti i kaluar prapë është në nivel të mirë dhe duket se edhe këtë vit ka arritur të arkëtoj edhe një pjesë të borxhit, të mbetur nga vitet e kaluara.

Rritja e faturimit në euro prej 15% ka ndikuar që norma e punës të jetë më e lartë krahasuar me vitin 2018, nga 0.82 në 0.89 në 2019. Norma e mbulimit të punës ka rënë për 3% në raport me vitin 2019 dhe mbetet ende nën nivelin e dëshiruar për ti mbuluar shpenzimet e krijuara gjatë vitit 2019 për shërbimet e ofruara.

Shpenzimet operative për njësi në vitin 2019, kanë mbetur në nivelin e njëjtë më vitin 2018, rreth 0.03 €/m^3.

4. KUALITETI I TË DHËNAVE

Ky raport bazohet në burimet kryesore të informacioneve të dorëzuara nga KRU përmes 'Raportit Vjetor', si dhe të dhënat tjera të raportuara në ARRU. Të dhënat e cilësisë së ujit janë të siguruara nga IKSHPK, përderisa disa të dhëna statistikore janë marrë nga publikimet e ASK dhe janë marrë si të mirëqena. Edhe këtë vit të dhënat e raportuara i janë nënshtruar procesit të auditimit/verifikimit. Për dallim nga vitet e kaluara, këtë vit të dhënat janë verifikuar nga distanca (zyra), në bazë të dokumenteve të dërguara në formate elektronike, si dhe komunikimit të vazhdueshëm me zyrtarët përgjegjës të KRU. Aktiviteti është zhvilluar gjatë muajit korrik 2020, mënyra e punës dhe kjo periudhë kohore është imponuar duke pasur parasysh situatën e krijuar emergjente me COVID-19.

Një përmbledhje e përgjithshme e shkurtë e vlerësimit të saktësisë dhe besueshmërisë në raport me të dhënat e gjetura nga auditimi rregullator[6], janë dhënë në vijim:

Tab. 10. Besushmeria e të dhënave sipas KRU

KRU	Të dhënat jo financiare-ujësjellës	Të dhënat jo financiare-ujëra të ndotura	Të dhënat financiare	Mesatarja e përgjithshme ponderuar
Gjakova	96%	92%	100%	98.9%
Hidromorava	95%	89%	100%	98.6%
Prishtina	91%	74%	100%	97.0%
Hidroregjioni Jugor	92%	95%	91%	91.2%
Hidrodrini	81%	66%	89%	86.0%
Mitrovica	87%	68%	85%	84.6%
Bifurkacioni	70%	95%	68%	70.4%

Saktësia e të dhënave operative, në përgjithësi vijon të jetë me saktësi më të ulët në raport me të dhënat financiare dhe ato të shërbimeve ndaj konsumatorëve: Prodhimi i ujit, në përgjithësi, përjashtuar KRU 'Prishtina', është raportuar saktë. Presioni dhe të dhënat për pronat e ndikuara me shtypje të ulët nga shumica e KRU nuk janë raportuar, ndërsa në dy KRU (Hidrodrini dhe Hidromorava), këto të dhëna kanë rezultuar të jenë të pa sakta. Të dhënat për vazhdimësinë e furnizimit më ujë nga KRU të cilat kanë aplikuar ndërprerje dhe të dhënat për ujëmatësit përjashtuar disa KRU (Prishtina, Mitrovica dhe Bifurkacioni), janë raportuar saktë. Përderisa të dhënat për defektet dhe gjatësinë e rrjetit të ujësjellësit, janë gjetur saktë të raportuara nga të gjitha KRU. Saktësia e të dhënave të shërbimit ndaj konsumatorëve në përgjithësi rezultojnë të jenë raportuar me saktë se sa të dhënat operative. Në këtë aspekt ende pasaktësitë me tepër lidhen tek raportimi i ankesave dhe ujëmatësit, kryesisht për shkakun e paqartësisë së definicioneve. Të dhënat që kanë të bëjnë me: matjen, shitjen dhe kontratat janë saktë të raportuara. Të dhënat financiare, janë gjetur saktë të raportuara nga të gjitha KRU me përjashtim tek KRU 'Bifurkacioni', tek e cila pasaktësia e raportimit të të dhënave lidhet kryesisht me shkakun e pa çartësisë së definicioneve të të dhënave.

Aktiviteti i auditimet ka përfshirë verifikimin e besueshmërisë së të dhënave në raport me kriteret e definuara në "udhëzuesin për avancimin e sistemit të monitorimit në ARRU dhe në KRU".

Besueshmëria e të dhënave, po ashtu lënë shumë për të dëshiruar, ku asnjëra nga KRU nuk i ka të dhënat plotësishtë të besueshme. Në rastin më të mirë janë: KRU 'Gjakova' me 98.9%, 'Hidromorava' me 98.6%, dhe 'Prishtina' me 97.0%. Besueshmëria e përgjithshme më e ulët është evidentuar tek Bifurkacioni me 70.4%.

Shqetësimet e Autoritetit janë në drejtim të besueshmërisë së ulët të të dhënave operative dhe disa të dhënave nga shërbimi i konsumatorëve: Prodhimi i ujit, vetëm nga tri kompani (Mitrovica, Gjakova dhe Hidromorava) është raportuar si "e besueshme", përderisa tek kompanitë e tjera kjo e dhënë është pjesërishtë e besueshme. Disa nga KRU ende për një pjesë të prodhimit të ujit të dhënat i bazojnë në vlerësime. Presioni i ujit është e dhëna më së

[6] Raportet e Auditimit/Verifikimit të të dhënave të Raportuara-2019

paku e besueshme, asnjë nga KRU nuk kanë një sistem të besueshëm të matjes dhe raportimit të presioneve në rrjetin shpërndarës. Në rastin më të mirë janë: KRU 'Gjakova' dhe 'Mitrovica', këto dy KRU i kanë të vendosur në disa pika manometrat, dhe bëjnë leximin manual të rregullt të tyre. Të dhënat për defektet, bllokimet, gjatësinë e rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve, kryesisht janë: 'pjesërishtë të besueshme', këto të dhëna në përgjithësi janë të regjistruara në module përkatëse (GIS, CRM, etj) por nuk janë plotësishtë të azhurnuara dhe të përdistuara.

Të dhënat e shërbimit ndaj konsuamtorëve dhe të dhënat financire, janë kryesisht të besueshme meqë bazohen dhe regjistrohen në mënyrë të rregullt në module përkatëse. KRU 'Bifurkacioni', këtë vit ka raportuar të dhëna finaciare 'jo të besueshme' kryesisht për faktin e mos kuptimit të definicioneve.

5. KONKLUZIONE TË PËRGJITHSHME

Gjatë analizës së performancës së KRU, siç është paraqitur në këtë raport, mund të vijmë në përfundim për një numër çështjesh kyçe në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar nga KRU, si dhe qëndrueshmërinë financiare-operative të tyre:

Në përgjithësi, performanca e KRU në 2019 krahasuar me 2018, ka treguar përmirësim në standardet e shërbimit:

Qasje në shërbime të ujësjellësit në vendbanimet e tyre, kanë 3/4 e popullatës, përderisa 2/3 e tyre marrin shërbime të kanalizimit të ujërave të ndotura nga KRU, brenda regjioneve të tyre respektive të shërbimeve, të shpërndara në 32 komuna prej 38- sish, sa janë gjithsej në Kosovë. Pjesa tjetër e popullatës e shpërndarë në vendbanime, kryesisht rurale, janë ende jashtë sistemit publik të furnizimit me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit. Trajtimi i ujërave të ndotura është në nivel shumë të ulët. Aktualisht në fazën e projektimeve dhe ndërtimeve janë ITUN, në disa qendra regjionale (Prizren, Gjakovë dhe Pejë).

Cilësia e ujit është e mirë dhe brenda standardeve vendore, ndonëse me disa probleme të paraqitura këtë vit në KRU 'Hidromorava' dhe 'Bifurkacioni', shkaku i mungesës së furnizimit me ujë. Dy nga shtatë kompani, KRU 'Prishtina' dhe 'Gjakova', kanë laboratorët e akreditur, dhe janë në gjendje të ju përgjigjen kërkesave të testimit edhe monitorimit të cilësisë së ujit të pijshëm sipas legjislacionit vendor, përderisa edhe KRU e tjera në këtë drejtim, janë angazhuar për ndërtimin e laboratorëve, pajisjen dhe akreditimin e tyre, për testimin e cilësisë së ujit.

Sigurimi i presioni adekuat (ligjor) të ujit, nuk konsiderohet si problematike, megjithëse disa prej kompanive (KRU 'Hidromorava'), kanë raportuar për një numër të vogël pronash që nuk mund të furnizohen më presion të mjaftueshëm. ARRU është e bindur se shumica e KRU, ende nuk kanë mundësinë që të monitorojnë dhe sigurojnë informacione të besueshme për presionet në rrjetin e tyre të shërbimit të ujësjellësit, meqenëse ato nuk kanë sistem të vendosur të manometrave dhe monitorimit On-linë të rrjetit shpërndarës.

Të gjitha KRU kanë shënuar progres me pajisjen e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës, aktualisht vetëm 4%, të tyre nuk janë të pajisur me ujëmatës. ARRU në vazhdimësi, e sidomos nga viti 2018, ka kërkuar nga të gjitha ndërmarrjet e ujit të vendosin matjen e detyrueshme të konsumit të ujit për konsumatorët e tyre. Faturimi i saktë i konsumatorëve përmes ujëmatesëve është një prej standardeve ligjore që duhet përmbushur nga KRU.

Përkundër përmirësimeve të përmendura, raporti ka identifikuar fusha të cilat kanë nevojë për më shumë përmirësime, kryesisht të lidhura me efiçencën operative dhe financiare:

UPF është ende në vlera të larta pa përjashtim nga të gjitha KRU. Aktualisht kjo është një nga sfidat më të mëdha me ndikim në efiçencen operative-financiare, si dhe nivelin e shërbimeve të ofruara nga KRU. Ato vazhdojnë me zbatimin e strategjive individuale dhe ARRU ka inkurajuar kompanitë që projeksionet e parapara në këto strategji t'i përfshijnë në biznes planet e tyre në menyrë që ato t'i shqyrtojë për t'i marrë parasysh gjatë proceseve tarifore.

Në efiçencën e arkëtimit, të gjitha kompanitë kanë shënuar rezultate pozitive.Norma e arkëtimit e të ardhurave aktualisht arritn nivelin 93%. Gjatë vitit financiar në shqyrtim të gjitha KRU arritën t'i përmbushin synimet e tyre për arkëtimin e të hyrave të përcaktuara me procesin tarifor. Autoriteti ka kërkuar nga KRU që edhe më tej të vazhdojnë me ngritjen e efiçencës për arkëtimin e borgjeve.

Efiçenca e kostove mbetet ende sfidë për të gjitha KRU, për arsye se kanë tejkaluar shpenzimet operative të planifikuara, përderisa shpenzimet për mirëmbajtje kapitale (ripërtëritjen infrastrukturore dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale për asetet e reja) janë shumë minore dhe nuk kanë arritur as 50% ti realizojnë nga ato të planifikuara gjatë procesit tarifor 2018-2020.

Cilësia e të dhënave të raportuara në ARRU, ende nuk është në nivelin e kënaqshëm, në përgjithësi ato konsiderohen pjesërisht të besueshme. Kompanitë ende nuk e kanë zhvilluar sistemin e informacionit në nivel të avancuar. ARRU kërkon zhvillimin më tutje të sistemeve të kontrollit dhe monitorimit të shërbimit, përfshirë proceset e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit.

SHTOJCA 1: Pasqyrat përmbledhëse të të ardhurave (URRK)

KRU Prishtina (Prishtinë)

	2018	*2019*
Qarkullimi	14,311,278	14,673,192
Shpenzimet operative	10,090,504	10,232,526
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	**4,220,774**	**4,440,666**
Mirëmbajtja kapitale (përtritja infrastrukturore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	2,609,091	722,777
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	**1,611,683**	**3,717,889**
Provizionimi i borxheve të këqija	1,749,251	414,729
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	**- 137,568**	**3,303,159**
Kamata në huatë afatgjata	0	0
Profiti para tatimit	**-137,568**	**3,303,159**
Tatimi në profit	0	0
Profiti neto pas tatimit	**-137,568**	**3,303,159**

KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren)

	2018	**2019**
Qarkullimi	4,367,127	4,823,060
Shpenzimet operative	3,635,492	3,978,733
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	**731,635**	**844,327**
Mirëmbajtja kapitale (përtritja infrastrukturore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	136,336	225,169
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	**595,299**	**619,158**
Provizionimi i borxheve të këqija	232,845	189,502
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	**362,454**	**429,656**
Kamata në huatë afatgjata	0	
Profiti para tatimit	**362,454**	**429,656**
Tatimi në profit	0	
Profiti neto pas tatimit	**362,454**	**429,656**

KRU Hidrodrini (Pejë)

	2018	2019
Qarkullimi	3,760,089	3,992,965
Shpenzimet operative	2,494,085	2,538,716
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	**1,266,003**	**1,454,249**
Mirëmbajtja kapitale (përtritja infrastrukturore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	149,034	157,708
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	**1,116,969**	**1,296,541**
Provizionimi i borxheve të këqija	757,996	504,787
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	**358,973**	**791,754**
Kamata në huatë afatgjata	0	
Profiti para tatimit	**358,973**	**791,754**
Tatimi në profit	0	
Profiti neto pas tatimit	**358,973**	**791,754**

KRU Mitrovica (Mitrovicë)

	2018	2019
Qarkullimi	3,910,751	4,418,591.
Shpenzimet operative	3,135,639	3,430,928
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	**775,112**	**987,663**
Mirëmbajtja kapitale (përtritja infrastrukturore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	19,759	20,942
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	**755,353**	**966,721**
Provizionimi i borxheve të këqija	1,485,080	947,924
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	**-729,728**	**18,797**
Kamata në huatë afatgjata	0	
Profiti para tatimit	**-729,728**	**18,797**
Tatimi në profit	0	
Profiti neto pas tatimit	**-729,728**	**18,797**

KRU Gjakova (Gjakovë)

	2018	2019
Qarkullimi	4,395,523	4,568,298
Shpenzimet operative	3,154,938	3,541,549
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	**1,240,585**	**1,026,749**
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukturore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	610,600	362,003
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	**629,985**	**664,746**
Provizionimi i borxheve të këqija	541,787	151,316
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	**88,198**	**513,429**
Kamata në huatë afatgjata	0	
Profiti para tatimit	**88,198**	**513,429**
Tatimi në profit	0	
Profiti neto pas tatimit	**88,198**	**513,429**

KRU Bifurkacioni (Ferizaj)

	2018	2019
Qarkullimi	2,163,193	2,071,257
Shpenzimet operative	1,599,025	1,573,376
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	**564,168**	**497,881**
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukturore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	25,900	30,918
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	**538,268**	**466,963**
Provizionimi i borxheve të këqija	410,209	436,622
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	**128,059**	**30,341**
Kamata në huatë afatgjata	0	
Profiti para tatimit	**128,059**	**30,341**
Tatimi në profit	0	
Profiti neto pas tatimit	**128,059**	**30,341**

KRU Hidromorava (Gjilan)

	2018	2019
Qarkullimi	2,299,768	2,467,273
Shpenzimet operative	1,656,916	1,806,015
Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	**642,851**	**661,258**
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukturore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	40,955	42,845
Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)	**601,896**	**618,413**
Provizionimi i borxheve të këqija	454,099	375,669
Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)	**147,798**	**242,744**
Kamata në huatë afatgjata	0	
Profiti para tatimit	**147,798**	**242,744**
Tatimi në profit	0	
Profiti neto pas tatimit	**147,798**	**242,744**

SHTOJCA 2: Detajet e kontaktit

Albana Abazi-Haliti

Analiste e Performancës Teknike

Tel (+383 38 249 165-lok 137)

albana.abazi@arru-rks.org

Jasmina Bujupi

Analiste e Performancës Financiare

Tel (+383 38 249 165-lok 117)

jasmina.bujupi@arru-rks.org

Lule Aliu

Zyrtare për Informim dhe Monitorim të Mediave (Asistente Ekzekutive)

Tel (+383 38 249 165-lok 101)

lule.aliu@arru-rks.org

Mejreme Qerimi

Analiste e Shërbimeve me Konsumatorë

Tel: (+383 38 149-165- lok: 113

mejreme.qerimi@arru-rks.org

Informacionet për ARRU

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit – ARRU

Tel:+383 38 249 165

Mob:+383 45 999 630

Web: http://arru-rks.org/

	Emri	Nr. I telefonit	E-mail adresa	Adresa
Drejtor	Raif Preteni	038/249 165 111	raif.preteni@arru-rks.org	Rr. Ali Pashë Tepelena, Prishtinë, 10000
Zëvendës Drejtor	Xhelal Selmani	038/249 165/114	xhelal.selmani@arru-rks.org	Rr. Ali Pashë Tepelena, Prishtinë, 10000
Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Licencim	Behxhet Bala	038/249 165/112	behxhet.bala@ arru-rks.org	Rr. Ali Pashë Tepelena, Prishtinë, 10000
Drejtor i Departamentit për Raportim të Performancës	Qamil Musa	038/249 165/121	qamil.musa@ arru-rks.org	Rr. Ali Pashë Tepelena, Prishtinë, 10000
Drejtor i Departamentit për Tarifa	Refik Rama	038/249 165/120	refik.ramaj@ arru-rks.org	Rr. Ali Pashë Tepelena, Prishtinë, 10000
Drejtor i Departamentit për Administratë dhe Financa	Ramiz Krasniqi	038/249 165/110	ramiz.krasniqi@ arru-rks.org	Rr. Ali Pashë Tepelena, Prishtinë, 10000
Udhëheqës i Njësisë për Inspektim	Zoge Spahiu	038/249 165/135	zoge.spahiu@arru-rks.org	Rr. Ali Pashë Tepelena, Prishtinë, 10000

SHTOJCA 3: Harta e mbulueshmërisë me shërbime

Zona e shërbimit të KRU-ve dhe mbulueshmëria me shërbime - Viti 2019

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova
AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY
ARRU

Emri i KRU-së	Komunat në zonë të shërbimit
"Prishtina"	Prishtinë,Podujevë, Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Drenas, Shtime, Graçanicë
"Hidroregjioni - jugor"	Prizren, Suharekë, Malishevë, Dragash, Mamushë
"Hidrodrini"	Pejë, Klinë, Istog, Deçan, Junik
"Mitrovica"	Mitrovicë Jugore, Vushtrri, Skenderaj
"Gjakova"	Gjakovë, Rahovec, Prizren (vetëm 10 fshatra të kësaj komune)
"Bifurkacioni"	Ferizaj, Kaçanik, Han i Elezit
"Hidromorava"	Gjilan,Viti, Kamenicë, Ranillug, Novobërdë, Partesh.
Komuna pa menaxhim të KRU	Zubin Potok, Leposaviç, Mitrovicë e Veriut, Kllokot, Shtërpcë, Zveçan.

Shënim:

Gjashtë komuna nuk janë ende të konsoliduara zyrtarisht në ofrues rajonal dhe rrjedhimisht janë të palicencuara.

Këto gjashtë komuna janë:

Leposaviç	Shtërpcë
Zubin Potok	Mitrovicë e Veriut
Zveçan	Kllokot

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit



Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit



ARRU - Autoriteti Rregullator për Shërbime të ujit

Rr.Ali pashë Tepelena, Nr.01

Prishtinë